



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr.____ prot.

Tiranë, më 11.10.2019

Lënda: *Shpjegime në seancën gjyqësore të datës 11.10.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen që i përket shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, më të cilin është konfirmuar në detyrë subjekti i rivlerësimit z. Artur Malaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë*

Të nderuar zonja dhe zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

Në seancën gjyqësore të datës 3.10.2019, të zhvilluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, Komisioneri Publik shprehu dakordësinë lidhur me metodologjinë e analizës financiare, të përgatitur nga Njësia Ligjore e Kolegjit. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i kësaj analize, ka konstatuar se:

- *Në analizën paraprake ekonomiko-financiare, është detajuar metodologjia e përdorur për realizimin e saj;*
- *Janë verifikuar dhe analizuar deklaratimet e subjektit dhe të personit të lidhur pranë ILDKPKI-së për këtë periudhë;*
- *Janë marrë në konsideratë dhe janë pasqyruar pretendimet e Komisionerit Publik, të paraqitura në shkaqet e ankimit dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor për shtrirjen e analizës financiare në të gjitha vitet e deklaratimit, për të gjitha asetet e subjektit të rivlerësimit;*
- *Janë analizuar burimet financiare, shpenzimet dhe kursimet e subjektit dhe të personit të lidhur për periudhën 2003 -2016.*

Sa më sipër, Komisioneri Publik, ashtu sikurse deklaroi dhe në seancën e datës 3.10.2019, çmon se në analizën paraprake financiare janë analizuar të dhënat e akteve të administruara, si dhe kjo analizë pasqyron situatën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të, për vitet objekt kontrolli.

Subjekti i rivlerësimit parashtrroi kundërshtimet e tij lidhur me këtë analizë, duke e konsideruar të gabuar dhe të pabazuar në prova, si dhe i kërkoi trupit gjykues marrjen si provë të disa akteve të reja dhe kryerjen e një analize të re financiare, nga një ekspert kontabël i pavarur, për të

mundësuar zhvillimin e një procesi në kushtet e paanësisë. Pasi u konsultua, trupi gjykues vendosi të pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, ndërsa rrezoi kërkesën e tij për kryerjen e ekspertimit kontabël, duke e konsideruar të panevojshme, bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në përgjigje të kërkesës së Komisionerit Publik për një kohë të arsyeshme për t’u shprehur mbi vlerën provuese të provave në tërësi, trupi gjykues vendosi të shtyjë seancën gjyqësore për sot, në datën 11.10.2019, ora 11:00.

Komisioneri Publik, në vijim të shqyrtimit gjyqësor, fillimisht dëshiron të qartësojë dhe të ripërsërisë qëndrimin e tij të shprehur në ankimin e datës 26.10.2018, në shtesën e ankimit të datës 4.7.2019, parashtrimet e datës 19.7.2019, para Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pohimit gjyqësor të dokumentuar në procesverbalin e seancës në Kolegj, të datës 19.7.2019, se ka kërkuar rivlerësim të të gjithë asetit pasuror, për të vlerësuar nëse subjekti ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 59/1, germa “a”, e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pretendimet e subjektit mbi të ardhurat e realizuara nga fitimi i aktivitetit noterial të bashkëshortes, vlerësojmë se aktet në dosje faktojnë të kundërtën e interpretimeve të subjektit të rivlerësimit në kundërshtimet e paraqitura në datën 3.10.2019. Rreth këtij pretendimi, Komisioneri Publik citon faktin që, sipas parimeve të kontabilitetit, çdo veprim i cili ndërmerret në pasqyrat financiare, duhet të ketë një akt shoqërues, i cili justifikon këtë veprim dhe legjitimon kërkesën e subjektit të rivlerësimit. Në këtë akt nuk e gjejmë në aktet që shoqërojnë pasqyrat financiare.

Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për pjesën e legalizimit të kapitalit të kryer nga bashkëshortja e subjektit, në vitin 2011, për fitimet e vitit 2009, duhet të theksojmë që në dosje gjendet vetëm përgjigja e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe e Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, si organ i specializuar për të bërë interpretimin e këtij fakti, dhe kjo e fundit, me shkresën nr. ***, datë ***.10.2019, ka dhënë një interpretim të tillë. Nga falja e detyrimeve tatimore dhe doganore përjashtohen zyrtarët që kanë detyrim për deklarim të pasurisë, si dhe personat juridikë në të cilët këta zyrtarë kanë aksione apo kuota kapitali. Kjo përgjigje është bazuar në nenin 18, të ligjit nr. 10418, datë 21.4.2011. Ndërkohë, në të njëjtin ligj, në nenin 6 të tij, citohet që përjashtohen nga kjo amnisti fiskale individët të cilët, në përputhje me legjislacionin e fushës, i nënshtrohen detyrimit ligjor për deklarimin e pasurisë pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive. Rreth këtij pretendimi, Komisioneri publik çmon se është e rëndësishme të vlerësohet nëse kjo Drejtori në përgjigjen drejtuar bashkëshortes së subjektit ishte në dijeni të faktit që bashkëshortja e subjektit ishte subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së. Komisioneri Publik, në interpretimin e këtyre dy neneve, mban qëndrimin se neni 6 i ligjit nr. 10418, datë 21.4.2011, prevalon ndaj nenit 18 të këtij ligji, i cili referon në tërësi tatimpaguesit.

Lidhur me vlerën provuese të akteve shkresore të administruara në tërësi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në vijim paraqesim qëndrimin e Komisionerit Publik, vetëm mbi ato akte të cilat paraqesin rrethana faktike dhe kanë vlerë provuese, dhe jo mbi pjesën tjetër të akteve që janë në kushtet e interpretimeve ligjore, dhe për të cilat Komisioneri Publik çmon se nuk duhet të merren parasysh nga trupi gjykues i Kolegjit.

Në vlerësimin e Komisionerit Publik kanë vlerë provuese aktet si më poshtë:

1. Kopje e deklaratës së interesave vjetore 2005, të njësuar me vulën e institucionit përgjegjës, ILDKPKI. Të dhënat e pasqyruara në këtë deklaratë janë marrë në konsideratë në analizën paraprake të vënë në dispozicion nga Kolegji.
2. Shkresa nr. *** prot, datë ***.9.2019, e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vlorë, mbi fitimin e realizuar. Ky fitim është marrë në konsideratë në analizën paraprake të vënë në dispozicion nga Kolegji.
3. Shkresa nr. *** prot., datë ***.9.2019, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, mbi të ardhurat nga paga e bashkëshortes për vitin 2008. Këto të ardhura dhe të ardhurat e vitit 2010, që janë të deklaruara në pasqyrat financiare të personit fizik ***,***, janë marrë në konsideratë në analizën paraprake të vënë në dispozicion nga Kolegji.
4. Shkresa nr. ref. ***/2019, datë ***.7.2019, lëshuar nga Zyra e Këshillit të Europës, Tiranë, në të cilën shpjegohet se të gjitha shpenzimet e pjesëmarrjes të z. Malaj, në vizitën studimore të datës 22-25 janar 2008, janë mbuluar nga Këshilli i Europës.
5. Deklaratë noteriale e shtetasit ***,***, e datës ***.8.2019, e vetmja nga 3 deklaratat e paraqitura nga subjekti, e shoqëruar me certifikatën e vendbanimit historik të këtij shtetasi në Komunën ***, Itali, në të cilën ky shtetas konfirmon se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë qenë të ftuarit e tij nga data ***.1.2008 deri në datën ***.1.2008 dhe vetëm bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nga data ***.6.2011-***.6.2011.
6. Vërtetimi i shoqërisë “***” sh.p.k., i datës ***.9.2019, nënshkruar nga z. ***,***, në të cilin specifikohet koha dhe vlera e kryerjes së shpenzimeve të mobilimit për periudhat 2007, 2010 dhe 2011, për sa kohë deklaratimet e subjektit nuk bien ndesh me deklaratimet e tij në përgjigje të pyetësorit nr. 1, realizuar nga Komisioni.

Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk ndikojnë në arritjen e një përfundimi të ndryshëm, për sa ka rezultuar nga analiza financiare paraprake e paraqitur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, si dhe nuk ndikojnë në ndryshimin e asnjë prej shkaqeve të ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik.

KOMISIONERI PUBLIK
Darjel SINA